REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.5750 prot.

Lushnje më, 16/06/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK

Këtu

"MBI NJË NDRYSHIM TË VKB-SË NR 122 DATË 23.12.2025 "MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026 SI DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 (PBA) TË BASHKISË LUSHNJE"

Të nderuar zonja dhe zoterinj këshilltarë!

Në kuadër të përmirësimit të ofrimit të shërbimit në çerdhe dhe përballimit të rritjes së numrit të fëmijëve të regjistruar, paraqitet për miratim propozimi për shtimin e një grupi të ri, në organikën e Qendrës së Arsimit,Bashkia Lushnje.
Gjatë viteve të fundit,është konstatuar një rritje e numrit të fëmijëve që frekuentojnë çerdhen, si dhe kërkesa të shtuara të prindërve për regjistrime të reja. Kapacitetet ekzistuese dhe organizimi aktual i grupeve kanë një fluks të shtuar të fëmijëve, duke sjellë nevojën për krijimin e një grupi shtesë.

Shtimi i grupit të ri do të mundësojë sistemimin më të mirë të fëmijëve sipas grupmoshave, përmirësimin e kushteve të qëndrimit dhe edukimit, respektimin e standardeve të përcaktuara për raportin staf–fëmijë, si dhe garantimin e një shërbimi më cilësor dhe më të sigurt për të gjithë fëmijët përfitues,në objektin e ri të rikonstruktuar nga Bashkia Lushnje.Kjo ndërhyrje vlerësohet e nevojshme për të përmbushur kërkesat aktuale dhe për të shmangur mbingarkesën e grupeve ekzistuese.

Theksojmë se ky ndryshim nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në fondin e pagave, pasi funksionimi i grupit të ri do të realizohet nëpërmjet riorganizimit të brendshëm të organikës ekzistuese dhe me shtim të vetëm prej 3 punonjësish të numrit të përgjithshëm të punonjësve.
Ju faleminderit!
Konc.E.Qaliu

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.5750 Prot.

Lushnje më, 16/06/2026

PROJEKT- VENDIM

NR. 53, DATË 16 / 06 / 2026

"MBI NJË NDRYSHIM TË VKB-SË NR 122 DATË 23.12.2025 "MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026 SI DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 (PBA) TË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak Lushnje në mbledhjen e tij të datës / / 2026 me propozim të kryetarit të Bashkisë, si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Per vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 9 pika 1.3 gërma "c", neni 18 pika 1.neni 54 germa "dh" si dhe neni 41; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore neni 4, neni 5 gërma "a", neni 6 gërma "d", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 6 dhe 17,Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore",Udhëzimit nr.8 datë 28.2.2025 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Progamit Buxhetor Afatmesëm Vendor për vitet 2026-2028" si dhe në shkresën me nr 15867 prot datë 06.11.2025 e Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2026,*Urdhrit me Nr 361/2 datë 15.06.2026 „ Mbi një ndryshim të Urdhërit Nr 361/1 Datë 17.02.2026 „ Për Miratimin e Strukturës/ Organikës dhe Kategoritë/Klasat e Pagave të Bashkisë Lushnje dhe Ndërmarrjeve Vartëse Për Vitin 2026",* *si dhe shkresës me nr 309 prot.Datë 09.06.2026" Kërkesë për shtesë në strukturën organike,për hapjen e grupeve të reja për cerdhe",*

PROPOZOJMË :

1. Ndryshimin e pikës II të VKB nr 122 datë 23.12.2025, përkatësisht ndryshimin e numrit të punonjësve buxhetor gjithsej nga 1100 punonjës të bëhët 1103 punonjës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e

Financës dhe Buxhetit dhe Qendra e Arsimit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore
Erisa Qalliu

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
Ervisa Çuko
P/

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

Adresa: Lagjia "Kongresi" Tel/Fax: +355 35 22139 E-mail: bashkia_lushnje@yahoo.com

5533
10.06.2026

Dr. Burimeve Mjeshtre

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
QENDRA E ARSIMIT

Nr 309 Prot

Lushnje më 09.06.2026

Lënda: Kërkesë për shtesë në strukturën organike, për hapjen e grupeve të reja për çerdhe

KRYETARES SË BASHKISË LUSHNJE znj.ERISELDA SEFA

Nisur nga numri i lartë i fëmijëve frekuentues në dy çerdhet e qytetit, si edhe numri i kërkesave të reja për regjistrim të fëmijëve në çerdhe, Qendra e Arsimit kërkon që të merret në konsideratë nga ju mundësia e hapjes së 2 (dy) grupeve për fëmijët e grupmoshës 0-3 vjeç të cilët frekuentojnë çerdhen, pranë ambienteve të godinës së re të arsimit parashkollor tek ish-gjendja civile.

Rrjedhimisht kërkojmë të merret parasysh mundësia e përfshirjes së stafit të nevojshëm për funksionimin e çerdhes, në strukturën organike të Qendrës së Arsimit. Për mirëfunksionimin e dy grupeve të çerdhes, do të nevojiten 4 (katër) edukatore për grupmoshën 0-3 vjeç, 2 (dy) kujdestare/sanitare, 1 (një) kuzhiniere, 1 (një) ndihmës kuzhiniere.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

DREJTORI

MUARREM SHARKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË QENDRA E ARSIMIT BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr. 11045/2 Prot

Lushnje, më 29.12.2025

VENDIM
NR 122 DATË 23-12.2025

"MBI MIRATIMIN E BUXHETIT VJETOR 2026" SI DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028(PBA) TË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 23.12.2025, pasi analizoi relacionin *"Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2026 si dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028(PBA) të Bashkisë Lushnje"*, si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar*, neni 9 pika 1.3 gërma "c", neni 18 pika 1.neni 54 gërma "dh" si dhe neni 41; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 4, neni 5 gërma "a", neni 6 gërma "d", Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 6 dhe 17. Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimit nr.8 datë 28.2.2025 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor për vitet 2026-2028" si dhe në shkresën me nr 15867 prot datë 06.11.2025 e Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2026.

VENDOSI:

I.Të miratojë buxhetin e Bashkisë Lushnje për Vitin 2026:

- Të ardhurat 2,132,797,335 lekë
- Shpenzimet 2,132,797,335 lekë

I/1. Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë Lushnje për vitin 2026 në shumën 2,132,797,335 lekë, si më poshtë:

Emërtimi	Plani 2026/ në lekë
I. Të ardhura lokale	925,579,000
1.Të ardhurat e viti 2026	640,579,000
a)Të ardhura të taksueshme	371,620,000
b)Të ardhura të jo tatimore	175,019,000
c)Të ardhura të tjera	93,940,000

2. Të ardhura të trashëguara nga viti.2025	285,000,000
II. Transferta e pakushtëzuar v. 2026	622,969,864
III. Transferta e pakushtezuar sektoriale v. 2026	584,248,471
TOTALI (I+II+III)	2,132,797,335

I/2. Të miratojë planin e shpenzimeve të Bashkisë Lushnje për vitin 2026 në vlerën 2,132,797,335 lekë, sipas klasifikimit ekonomik si më poshtë.

Nr.	Plani i shpenzimeve	Shpenzime 2026 /ë lekë
1	Shpenzime për paga	973,420,780
2	Shpenzime për sigurime shoqërore shëndetesore	167,251,956
3	Shpenzimet Operative	559,143,937
4	Investime	432,974,662
	TOTALI	2,132,797,335

Shpenzimet sipas programeve dhe njësive shpenzuese janë sipas tabelave bashkalidhur.

II. Të miratojë numrin e punonjësve buxhetore gjithsej 1100 punonjës sipas tabelës bashkalidhur dhe structures,si dhe 2 punonjës për projektin Rural Coop miratuar me VKB ar 57 datë 30.06.2025

III Fondi prej 40,000,000 lekë do të përdoret në subvencionimin e "K.F Lushnja 1930" sh.a.

IV.Të miratojë listen e projekteve të investimeve sipas tabelës bashkëlidhur.

V. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm përfundimtar:

- Për vitin 2027 në vlerën 2,106,177,469 lekë
- Për vitin 2028 në vlerën 2,127,113,743 lekë

(Tabelat Bashkëlidhur)

VI. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Të gjitha drejtoritë e bashkisë si dhe ndërmarrjet varësse.

VII. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT

Erjet Dhima